



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1006/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuse BIRN, paraqitur kundër Kryesuesit të Qendrës së Votimit QV, për shkak të pa rregullsive gjatë procesit të votimit, për raundin e dytë të Zgjedhjeve Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 04.12.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtues BIRN.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 02.12.2013 në ora 16:35 nga BIRN ku ka pretenduar se me dt. 01.12.2013 vëzhguesit nga BIRN kanë monitoruar zgjedhjet në qendrën e votimit nr.1704 C në shkollën fillore “Ramiz Sadiku” në Pejë ku rreth orës 18:55 ku ofrohej mbyllja e vendvotimeve në kohën kur provat të hyjë në vendvotimin me nr.1704C/04R kryesuesi i vendvotimit Kreshnik Haliti njëherit edhe komisioner nga radhët e PDK-së ka penguar që te jem i pranishëm në vëzhgimin kur do të numëroheshin fletëvotimet, thuhet në ankesë. Në bazë të këtij veprimi kryesuesi Kreshnik Haliti ka rënë ndesh me dispozita ligjore të LZP-së konkretisht neni 56 pika 1 a), b). Parashtruesi i ankesës i ka bashkangjitur si dëshmi emrat dhe numrin e kontaktit të drejtorit të shkollës Arif Ademaj dhe anëtareve tjerë të VV të lartpërmendura.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

ankesa është e pabazuar

Në ankesën e parashtruar nga BIRN pretendohet se ju është ndaluar hyrja vëzhguesit të BIRN në vendvotimin nr.1704C/04R nga kryesuesi Kreshnik Halili nga radhët e subjektit politik PDK..

PZAP-i, konstatoi se pretendimet ankimore janë të përgjithshme dhe të pa qarta për tu vërtetuar për shkeljen e supozuar nga ana e BIRN prandaj pasi që mungojnë prova bindëse me të cilat vihet në dyshim se është kryer një veprim i ndaluar, ankesa vlerësohet si e pa bazë, duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lartë përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 1006/2013 më datën 04.12.2013.



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24 orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.